



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 qershor 2017
Nr. ref.:RK 1082/17

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI144/16

Parashtrues

Sali Gerqina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave
të rregullta**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sali Gerqina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e gjykatave të rregullta (të tri instancave gjyqësore), por këto vendime nuk ia ka bashkëngjitur kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet shkelja e të drejtave të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 8 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti plotësimin e kërkesës me dokumentacion mbështetës.
8. Më 13 shkurt 2017, Posta e Kosovës e informon Gjykatën se adresa e parashtruesit (Rr. "Aleksandër Mojsiu", nr. 20) të kërkesës është e panjohur.
9. Më 23 mars 2017, Gjykata tentoi që shkresa e 8 shkurtit 2017 t'i dërgohet sërish parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, tentimi ishte i pasuksesshëm pasi që Posta e Kosovës, më 27 mars 2017, informoi Gjykatën se adresa e parashtruesit të kërkesës ishte e panjohur.
10. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e shkurtër e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend tekstualisht disa vendime të gjykatave të rregullta, me të cilat ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, megjithatë ato vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, sepse gabimisht kualifikuan natyrën e veprës penale, për faktin se sipas nenit 374.1, në lidhje me nenin 22 paragrafi (1), pika (75) të KPPRK-së, vepra penale konsiderohet krim i rëndë dhe e njëjta është dashur të trajtohej nga Prokurori i Krimeve të Rënda dhe nga gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit të Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore të Gjakovës, dhe jo nga Prokurori i Përgjithshëm dhe gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit të Përgjithshëm i asaj gjykate. Kjo shkelje sipas parashtruesit nuk është vërejtur dhe as nuk është vlerësuar nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, pas ushtrimit të mjeteve juridike.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.
14. Kësisoj, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 22 të Ligjit: *“Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...).”*
15. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 29 pikën (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullin 32 pikën (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që përcakton:

29 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

32 (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë (...).”

16. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 22, 29, 30, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës, për shkak të kualifikimit të gabuar të veprës penale.
17. Në zbatim të dispozitave të lartpërmendura, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa është jo e plotë, sepse asaj nuk i janë bashkëngjitur vendimet gjyqësore të kontestuara

(shih Vendimin për hedhje poshtë të kërkesës të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KIO3/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21, si dhe rastin KIO7/16, parashtrues *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).

18. Gjykata, nëpërmjet postës së rregullt, tentoi dy herë që të komunikonte me parashtruesin e kërkesës, për qëllim të plotësimit të kërkesës me dokumentacion mbështetës, megjithatë komunikimi ishte i pamundur pasi që adresa e parashtruesit, siç është dhënë në shkresat e lëndës, ishte e panjohur.
19. Gjykata vë në dukje se, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë adresë tjetër ose numër kontaktues, si alternativë për t'u kontaktuar. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se barra e përgjegjësisë për dështimin e kompletimit të kërkesës me dokumentacion mbështetës bie mbi parashtruesin e kërkesës.
20. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret formale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës.
21. Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 29 (2) (h) dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 22.4 dhe të rregullave 29 (2) (h) e 32 (5) të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi